




REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	2-0/DPK
Nr. i faq Broj stranica Nr. pages	03
Nr Prot. Br. Prot. Prot No.	01-908/15
Data Datum Date	26.03.2015
PRISHTINE	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	24.03.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-03-02/579/15
PËR/ZA/TO:	z. Agim Çeku, Deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik



I nderuari z. Çeku,

Lidhur me kërkesën tuaj të drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit, ju njoftojmë se; në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (L.P.K.I), Agjencia; “bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe për regjistrimin rast për rast të interesave”, (neni 19 (paragrafi 1.5) i Ligjit nr.04/L-051), lidhur me pyetjen tuaj të parashtruar ne kërkesën tuaj për situatë të mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të Deputetit të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht angazhimit si Drejtor dhe përfaqësues i autorizuar i organizatës joqeveritare jofitimprurëse Këshilli Euro – Atlantik i Kosovës, Agjencia Kundër Korrupsionit nxjerrë këtë Opinion :

O P I N I O N

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik mund të jetë anëtar i organeve drejtuese të organizatave, joqeveritare nga lëmi i veprimtarisë humanitare, të kulturës, sportit dhe të ngjashme pa të drejtë pagese, përjashtimisht kompensimit për shpenzime të udhëtimit, dhe të ngjashme.

Ndërsa angazhimi i juaj ne Organizatën joqeveritare “Këshilli Euro – Atlantik i Kosovës, është i pa pajtueshëm me funksionin e deputetit, pasi që ne statutin e kësaj organizate nuk thuhet se organizata merret me veprimtari humanitare, kulturës, sportit apo të ngjashme.

A R S Y E T I M

Duke e vlerësuar me konsideratë kërkesën tuaj ju njoftojmë se në kuadër të ushtrimit të kompetencave ligjore, përkatësisht sipas nenit 5 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia është autoritet qendror i cili ndër të tjera bën mbikëqyrjen dhe parandalimin e rasteve që kanë të bëjnë me konfliktin e interesit si dhe ndërmerr masat e parapara ligjore.

Në nenin 6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është paraparë nocioni i konfliktit të interesit i cili përcakton se “konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”, ndërsa neni 4 i këtij ligji ka përcaktuar kategorinë e zyrtarëve të lartë publik, të cilët i nënshtrohen këtij ligji. Rrjedhimisht në këtë nen janë paraparë edhe Deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Rrjedhimisht, Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051, në nenin 11 paragrafi (1, 2), ka përcaktuar anëtarësin e zyrtarit të lartë në organizata qeveritare, në të cilin shprehimisht thuhet:

1. Zyrtari i lartë mund të jetë anëtar i organit drejtues të organizatës joqeveritare nga lëmi i veprimtarisë humanitare, të kulturës, sportit dhe të ngjashme pa të drejtë pagese, përjashtimisht kompensimit për shpenzime të udhëtimit, dhe të ngjashme.
2. Organizata joqeveritare me anëtar të organit drejtues nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të përfitoj mjete nga buxheti i Kosovës nëse anëtari i organit drejtues të organizatës joqeveritare, në cilësinë e zyrtarit, ka ndikim të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në vendimmarrje, me rastin e vendosjes për Organizatat Joqeveritare përfituese nga mjetet e buxhetit të Kosovës.

Zyrtari i lartë në bazë të këtij neni mund të ushtron funksionin si anëtar i organit drejtues në organizata joqeveritare të lartpërmendura (humanitare, kulturës, sportit), ndërsa angazhimi në funksione tjera jashtë këtij nocioni mundë të sjell situatë të papajtueshme dhe konflikt të interesit

Organizata joqeveritare “Këshilli Euroatlantik i Kosovës” është organizatë jofitimprurëse e regjistruar në Ministrinë e Administratës Publike sipas Ligjit nr. 04/L-57, për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.

Në statutin e Organizatës joqeveritare “Këshilli Euro – Atlantik i Kosovës”, askund në përmbajtje nuk thuhet se organizata merret me veprimtari nga lëmi humanitare, kulturës, sportit apo të ngjashme.

Ligji për të drejtat dhe përgjegjësitë e Deputetit nr. 03/L-111, në nenin 7 ka përcaktuar mospërputhshmëri me aktivitetet ekonomike, ndërsa paragrafi 5 i këtij neni shprehimisht thuhet:

5. Deputeti nuk mund të kryejë aktivitete ekonomike që krijojnë konflikt të interesit.

Po ashtu zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm. Ligji nr 04/L-051, neni 7 (paragrafi 8).

Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik është i obliguar të bëjë deklarimin rast për rast të interesave private, sa herë që përfshihet në një vendimarrje të caktuar e që mund të bëhet shkasë për lindjen e konfliktit të interesit, Ligji nr 04/L-051, neni 13 (paragrafi 1 2 3).

Andaj bazuar në ato që u thanë më lartë, ju rekomandojmë që të zbatoni rregullat e parapara në dispozitat ligjore në fuqi, dhe të mos gjendeni në situatë të papajtueshme me funksionin që ushtroni e që do rezultonte me konflikt të Interesit.

Duke shpresuar që ky Opinion, do të sqarojë dyshimet e ngritura nga ju për situatën e mundshme të konfliktit të interesit, ju falënderojmë për besimin dhe konsideratën në institucionin tonë.

Me respekt!